

Operacioni "Kir" vë në pranga 45-vjeçar, nga armët e zjarrit tek lëndët plasëse, ja çfarë iu sekuestrua

Mar 18, 2019 | 16:37



Policia e Shkodrës ka vënë në pranga një 45 vjeçar, i cili dyshohet se në bashkëpunim me persona të tjerë, ushtronte veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve dhe armëmbajtjes pa leje.

Në pranga ka rënë shtetasi me inicialet K.Gj., 45 vjeç, nga fshatin Kir.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e tij në Kir, u gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale:

- 4.5 kg kanabis;
- 2 armë zjarri automatike;
- 19 kapsolla per lende plasëse;
- 10 metër fitil zjarrpërcjellës;
- 10 krehera;
- 77 fishekë;
- 2 radio marrëse e dhënëse.

Vijon puna për kapjen e personave të tjerë të implikuar në këtë aktivitet kriminal. Materialet iu referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

© **Panorama.al**


Subscribe



Për t'u bërë pjesë e grupit të "**Panorama**" mjafton të klikoni: **Join Group** dhe kërkesa do t'ju aprovohet.



Te lidhura



Protesta e pestë për vrasjen e Klodian Rashës/ Qytetarët mbledhen në sheshin 'Skënderbej'! Policia tenton t'i shpërndajë



"Nuk i nënshtrohemi diktaturës"/